



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 359/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ymer Hoxha kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Muharrem Nitaj nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet** si e bazuar ankesa e Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Muharrem Nitaj nga koalicioni PDK-AAK-NISMA.
- II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA në Vendvotimin: 0103C/03R.
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit në Vendvotimin si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.
- IV. Zgjim Selmonaj** me nr. të letërnjoftimit 1171109627, në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit 0103C/03R, i ndalohej pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 29.06.2017, nga kandidati për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës Muharrem Nitaj nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, me të cilën pretendon se pas rishikimit të raportit të vëzhguesve ka rezultuar se në vendvotimin 0103C/03R në Gramaçel ai ka pasur 51 vota, ndërsa të njëjtat votat e tij i janë regjistruar gabimisht kandidatit me numër 35.

Parashtruesi i ankesës si prova materiale bashkangjitur Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularët e Përputhjes së të dhënave për vendvotimet e lartcekura.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme “

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lendes, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutin e Votimit 0103C/03R është konstatuar se nga origjinali i Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK) kandidati me nr.34, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Komuna e Deçanit, nuk ka asnjë votë, në FRK-në, e cila është plotësuar në Vendvotim në ditën e votimit, ndërsa pas hetimit të bërë nga paneli, vërtetohet se parashtruesi i ankesës i posedon 54 vota të vlefshme.

Me rastin e vendosjes si në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi, përkitazi me masën e shqiptuar për ndalim të kryesuesit të vendvotimit, për pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), është marrë në bazë të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, sepse Kryesuesi i çdo Vendvotimi është përgjegjës për sigurinë e integritetit, dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim gjatë ditës së votimit, sipas dispozitës ligjore të nenit 74 par.10 të LZP-së, Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se kryesuesi i vendvotimit në fjalë, ka bërë shkelje të dispozitës së sipërcituar sepse parashtruesit të ankesës nuk i janë regjistruar asnjë votë në FRK, ndonëse pas hetimeve të bëra nga paneli është vërtetuar se i njëjti i posedon 54 vota.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur si në pikën II të dispozitivit

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par.3 Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr. 359/2017 më datën 02.07.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.